



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 50/6 prot.

Tiranë, 31.1.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik, kundër vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Alma Kolgjoka
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 18.1.2019, është njoftuar vendimi nr. 86, datë 17.12.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Alma Kolgjoka, me detyrë gjyqtare dhe Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, ushtron detyrën e gjyqtares dhe Kryetares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe, në bazë të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Procesi i rivlerësimit ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin znj. Alma Kolgjoka¹”, ka referuar se:

- i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin², ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka”.

2.3 Inspektorati pranë KLD-së, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit³. Komisioni, në mungesë të raportimit, për sa i përket aspektit drejtues të subjektit të rivlerësimit si Kryetar, e kreu vetë vlerësimin.

2.4 Komisioni, pas hetimit administrativ dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave lidhur me kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Kolgjoka, ka plotësuar së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit 84/2016, dhe ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit znj. Alma Kolgjoka, me funksion gjyqtare dhe Kryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.*

¹ Shkresa e ILDKPKI-së nr. *** prot, datë ***.1.2018.

² Shkresa e DSIK-së me nr.*** prot., datë ***.10.2017 (deklasifikuar).

³ Shkresa e Inspektoratit pranë KLD-së nr. *** prot., datë ***.4.2018.

II. Shkaqet e ankimit

3. Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting) dhe përfaqëson interesin publik.

4. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e këtij të fundit, pa pasur mundësinë ai vetë (Komisioneri), që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.

5. Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin në detyrë ose shkarkimin e magjistratit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara në fashikullin përkatës për çdo subjekt.

6. Komisioneri Publik, bazuar në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, dhe provave të administruara për këtë qëllim nga Komisioni, vlerëson se vendimi përmban shkaqe për t'iu paraqitur juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

7. Mbështetur në kërkesat kushtetuese e ligjore të sipërcituara dhe vlerësimin e provave dhe fakteve të administruara nga hetimi administrativ i Komisionit, në rastin konkret ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit, ushtrohet vetëm për kriterin e kontrollit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit znj. Alma Kolgjoka.

8. Komisioneri Publik konstaton se procesi i hetimit i Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk është i plotë, ka mangësi dhe, për rrjedhojë, në gjendjen që janë aktet nuk mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59, pika 1, germa "a" e ligjit nr. 84/2016.

9. Në të tilla rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se nëpërmjet këtij instrumenti procedural (ankim) do të bëhet e mundur që këto mangësi të vërejtura gjatë hetimit administrativ, nga ana e Komisionit, të mund të riparohen gjatë shqyrtimit të ankimit nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

10. Subjekti i rivlerësimit, znj. Kolgjoka, në përgjigje të pyetësorit standard nr. 1, datë ***.3.2018, të dërguar nga Komisioni, lidhur me vendbanimet ku ka jetuar gjatë periudhës 2011-2017, ndër të tjera përgjigjet, citoj: “...Duke filluar nga muaji shkurt 2017 e në vijim, për shkak të futjes së vajzës... në klasë të parë, për shkak të afërsisë së shkollës me shtëpinë e prindërve të mi, përkohësisht, në ditë të ndryshme, kam qëndruar te shtëpia e prindërve të mi, në adresën: Njësia Administrative nr. ***, rruga “**** **”, nd. ***, H. ***, ap. *** - Tiranë. Gjithashtu, prindërit e mi kujdesen edhe për djalin tim të vogël ...”.

10.1 Lidhur me këtë rrethanë, Komisioni ka kërkuar deklarime dhe dokumentacion provues nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Kolgjoka, e cila, në përgjigjen e saj nëpërmjet postës elektronike, të datës ***.10.2018, sqaron qëndrimin: “...përkohësisht, në ditë të ndryshme, për shkak të afërsisë së shkollës së vajzës (pasi shtëpia ime ndodhet shumë larg, te ***)”, si dhe bashkëngjijt disa dokumente shkresorë, si vijon:

- Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me rezervë, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2012;
- Njoftim i adresës së re të apartamentit në pronësi të babait tim, sipas kontratës së sipërcituar, e deklaruar në pyetësorin standard të Komisionit, datë ***.3.2018;
- Formular ankese/kërkesë nr. serie ***, drejtuar OSHEE-së;
- Kontratë për shërbime ujësjellës - kanalizime nr.***;
- Kopje e rrjetit rrugor të Njësisë Bashkiake nr. *** Tiranë.

10.1.1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Kolgjoka, në përgjigjet e pyetësorit të datës ***.10.2018, shprehet se: “...në lidhje me këtë apartament ende nuk janë bërë ndryshimet pranë ZVRPP Tiranë për kalimin e pronësisë”.

10.1.2. Sipas Kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.7.2012, lidhur në Tiranë, para noterit *** ***, figurojnë palë shitëse shoqëria “**** **” sh.p.k. dhe palë blerëse z. *** ** (i ati i subjektit të rivlerësimit), me objekt premtim shitje apartamenti, me sipërfaqe totale ndërtimi 141,87 m². Çmimi i kontratës është **11.065.860 lekë** (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë lekë). Për mënyrën e pagesës, blerësi ka shlyer të gjithë detyrimin që rrjedh nga kjo kontratë në çastin e nënshkrimit të saj, përveç shumës prej 5000 euro (pesë mijë euro), që do ta likuiojë në çastin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes.

10.1.3. Sipas “Formularit ankesë/kërkesë”, me nr. serie ***, drejtuar OSHEE-së, rezulton se z. *** ***, më datë ***.11.2012, ka bërë kërkesë pranë OSHEE-së për ndryshim emri, nga “****” (firma ndërtuese), të bëhet *** **.

10.1.4. Sipas Kontratës për shërbim ujësjellës-kanalizime nr.***, rezulton se kontrata për konsumatorin familjar, z. *** ***, mban datën ***.12.2012.

10.1.5. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2018, bën me dije se në emër të z. *** *** figuron 1 (një) pasuri aktive, apartament, me sipërfaqe 78.9 m², me adresë: rruga “**** **”, Pall. *** Tiranë.

10.1.6. Në deklaratat vjetore, të paraqitura pranë ILDKPKI-së, rezultojnë që në vitet 2008, 2009, 2010, në rubrikën: “Përbërja familjare e zyrtarit sipas certifikatës së gjendjes civile”, subjekti rivlerësimi deklaroi edhe prindërit (***) dhe vëllain (***). Në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës, me nr. indeksit ***, datë dorëzimi **.10.2007 dhe deklaratën e vitit 2007 deklarohet si kryefamiljare.

10.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, lidhur me të ardhurat në emër të z. *** dhe znj. **, sipas korrespondencës me institucionet financiare dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore, rezultojnë se për periudhën dhjetor 2002 deri në korrik 2012, kur është blerë apartamenti me sipërfaqe 141,87 m², të ardhurat janë si më poshtë:

Tabelë nr. 1 - Të ardhurat ***, ***, dhe **, **, dhjetor 2002 - korrik 2012

Viti	Të ardhura ***, ***, sipas Bank ⁴	Të ardhura ***, ***, sipas ISSH ⁵
2002	29,406	
2003	406,147	
2004	241,490	
2005	544,926	
2006	588,486	149,105
2007	740,643	162,660
2008	688,405	162,660
2009	739,696	162,660
2010	748,430	162,660
2011	780,103	162,660
2012	431,032	94,885
Totali	5,938,763 lekë	1,057,290 lekë

10.2.1. Gjithashtu, “*** Bank” konfirmon se shtetasi *** ka pasur disa llogari në lekë, të cilat aktualisht janë mbyllur. Nga verifikimi i nxjerrjeve të llogarive të vëna në dispozicion nga “*** Bank”, rezultojnë se: z. *** ka pasur një llogari bankare që prej vitit 2005 (nuk ka informacion përpara vitit 2005), në shumën 800.000 lekë. Ndër vite, kjo shumë është shtuar me interesa dhe derdhje në llogari, dhe në datë **.7.2011 është tërhequr *cash* shuma e akumuluar në këtë llogari, prej 1.020.000 lekësh.

10.2.2. Znj. ** ka pasur një llogari bankare në “*** Bank” në lekë, e cila aktualisht është e mbyllur. Nga verifikimi i kësaj llogarie bankare, na rezultojnë se znj. ** ka derdhur në këtë llogari shumën 100.000 lekë, në dhjetor të vitit 2006. Në **.7.2007, shuma e akumuluar në këtë llogari bankare, 101.421.96 lekë, është transferuar në favor të një shtetase.

10.3 Nga sa më sipër konstatohet se Komisioni nuk ka hetuar mbi mundësinë financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e investimit prej 11.065.860 lekësh, për blerjen e apartamentit në rrugën “***”, pasi nga të dhënat në dosjen e Komisionit nuk rezultojnë që ata të kenë pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

11. Komisioni, lidhur me këtë pasuri, ka arsyetuar se, citoj: “Gjithashtu, gjatë hetimit të thelluar, nga gjendja e akteve në dosje, trupi gjykoës konstatoi se babai i subjektit, me anë

⁴ Shkresë nr.*** prot., datë **.2.2018.

⁵ Shkresë nr.*** prot., datë **.2.2018

të kontratës së shitblerjes me rezervë ligjore, ka blerë një apartament me sipërfaqe 141.87 m², në vitin 2012. Trupi gjykues edhe në këtë drejtim verifikoi rrethanat nëse subjekti mund të vishej me ndonjë kualifikim të mundshëm si “person i lidhur” apo “personi tjetër i lidhur”, në kuptim të nenit 3, pika 14, dhe nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016. Në këtë drejtim, trupi gjykues konstatoi rrethanat se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë në vitin 2011 dhe ka dalë me certifikatë më vete me familjen e saj të re, dhe në kuptim të ligjit nr. 84/2016, në periudhën që babai i saj ka blerë apartamentin (viti 2012), nuk e kualifikon atë si “person të lidhur” apo “personit tjetër të lidhur”, në mënyrë që të bëhej vlerësimi i burimeve të ligjshme për këtë pasuri. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion edhe për sa kohë nga hetimi administrativ nuk i rezultoi ndonjë rrethanë tjetër ligjore, që mund të lidhte subjektin e rivlerësimit me ndonjë kontribut/shpenzim të mundshëm të saj mbi këtë pasuri”.⁶

12. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzioni i mësipërm nuk përputhet me situatën faktike bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje të Komisionit, pasi rrethanat ligjore që paraqiten për këtë pasuri janë të tilla që e lidhin subjektin e rivlerësimit, znj. Kolgjoka në *marrëdhënie interesi që rrjedh nga një interes pasuror* me z. *** ***, së paku sipas dy rrethanave faktike.

12.1. Rrethana e parë, subjekti i rivlerësimit, znj. Kolgjoka, ka deklaruar përbërje familjare për vitet 2008, 2009, 2010⁷ të njëjtë me z. *** dhe, nën regjimin e ekonomisë familjare të prezumuar, derisa nuk është provuar e kundërta, ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie.

12.2. Rrethana e dytë, subjekti i rivlerësimit, znj. Kolgjoka, në pyetësoin standard nr. 1, datë ***.3.2018, si dhe në shpjegimet e datës ***.10.2018, deklaron qëndrimin me ditë në shtëpinë e prindërve, për shkak të afërsisë së shkollës së të bijës, si dhe kujdesit për të birin, rrjedhimisht është në kushtet e përdorimit të sendit të paluajtshëm, apartament, për të cilin duhej bërë hetim i plotë dhe i gjithanshëm.

13. Më cilësimin si *person tjetër të lidhur* të z. *** ***, Komisioni do të duhej të verifikonte edhe përmbushjen e detyrimit ligjor të justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë, apartament me sipërfaqe 141,87 m², me vendndodhje në Tiranë.

14. Sjellim në vëmendje të Kolegjit se, për kuptimin e kategorisë së *personave të tjerë të lidhur*, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka arsyetuar se, citoj në një rast të ngjashëm:

“Trupi gjykues thekson se në ligjin nr. 84/2016, neni 3, pika 14, parashikohet rrethi i personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Nga ky përkufizim i përmbledhur del qartë që nuk përjashtohen familjarët të cilët nuk janë të përfshirë në certifikatën familjare, por që mund të kenë interesa pasurorë apo lidhje afektive me subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, sipas nenit 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin që të paraqesin të gjithë dokumentacionin që justifikon vërtetësinë e deklarimeve, por edhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tyre”⁸.

15. Nën dritën e sa më sipër, z. *** ***, i ati i subjektit të rivlerësimit, znj. Kolgjoka, duhej të cilësohet si person tjetër i lidhur.

⁶ Faqe 11 e vendimit.

⁷ Subjekti ka lidhur martesë në datë *** .***.2011.

⁸ Vendimi nr. 9, datë 24.10.2018, i KPA-së, për subjektin e rivlerësimit znj. Altina Xhoxhaj, paragrafi 64 i tij.

IV. Kërkimi i ankimit

16. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

17. Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b (5) të Kushtetutës, nenit C (2), Ç, D dhe F (7), të aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriterin e pasurisë, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se për subjektin e rivlerësimit gjen zbatim neni 59/1 i ligjit nr. 84/2016;

18. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7 e aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkohet që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, pas hetimit të plotë të kriterit të kontrollit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 86, datë 17.12.2018 ose

- Ndryshimin e vendimit nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Kolgjoka.

KOMISIONERI PUBLIK

DARJEL SINA